



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MBARËSHTIMI I KAFSHËVE DHE SHPENDËVE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

H3-III-19

Tiranë më, Shtator 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve”			Kodi H3-III-19
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK , është të përgatisë punonjës të kualifikuar për fushën e blegtorisë dhe shpendarisë, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me mbarështimin e blegtorisë dhe atë të shpendëve;			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve” të nivelit të III në KSHK, referuar nivelit III të KEK , kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK ; <ul style="list-style-type: none"> - janë kushte në shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; - kanë aftësi ndryshe, për të cilët institucionet përkatëse krijojnë kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve”, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të III në KSHK, referuar nivelit III të KEK , të nivelit të punonjësit të kualifikuar në tregun punës. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në fermat blegtorale, njësi apo veprimtari të tjera që lidhen me mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve në: fermat që mbarështojnë gjedh për prodhim qumështi dhe mishi, të imta, derra, shpendë, në prodhimin e mjaltit, rritjen e zogjve dekorativ, krimbit të mëndafshit apo të vetëpunësohet në drejtimet e sipërpërmendura në fermën e vogël familjare, në ekonomi ndihmëse pranë universiteteve, institucioneve të tjera (shkencore, aplikative), ekonomi agroturistike, kopshti zoologjik, si dhe në çdo njësi apo veprimtari tjetër që lidhen me kujdesin dhe mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve. Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit III të KEK , (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H-II-03-14			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Menaxhimi i fermës blegtorale.

- Të përshkruajë funksionet kryesore të menaxhimit të një veprimtarie ekonomike në fermën që mbarështon kafshë dhe shpendë;
- Të përshkruajë elementet bazë për hartimin e një plan biznesi;
- Të përshkruajë mundësitë për sigurimin e mjeteve monetare në mbështetje të veprimtarisë së fermës;
- Të vlerësojë rolin e kapitalit themelor të fermës (tokë, ndërtesa pajisje, makineri etj.) nëse është i mjaftueshëm për ngritjen e një aktiviteti blegtoral;
- Të përshkruajë rëndësinë e burimeve njerëzore të aftë për një prodhim dhe shërbim të specializuar në fermë;
- Të identifikojë faktorët e jashtëm si: (socialë, demografikë, ekonomikë), që ndikojnë në ngritjen aktiviteti;
- Të përshkruajë rëndësinë e faktorëve të brendshëm në zhvillimin e veprimtarisë ekonomike;
- Të përcaktojë llojin e kafshëve dhe shpendëve që do të mbarështojë ferma;
- Të shpjegojë mundësitë e sigurimit të energjisë, ujit, gazit etj. në fermën që mbarështon kafshë dhe shpendë;
- Të analizojë kostot e prodhimit dhe shërbimit në fermë, si dhe të ardhurat e fermës;
- Të hartojë pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në fermë;
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimit të rrjetit të bashkëpunimit me biznese të suksesshme të njëjta në vend.

Marketingu në fermë.

- Të identifikojë kërkesat e tregut për veprimtari ekonomike;
- Të rendisë metodat kryesore të studimit të tregut;
- Të përshkruajë procesin e planifikimit të promovimit (përcaktimi i objektivave, buxhetit, përpunimit dhe promovimit miks), mënyrat (fletëpalosje, reklamë televizive, konferenca promovionale, publicitet, etj.), si dhe rëndësinë e përdorimit të mediave;
- Të shpjegojë rolin e produktit si mall që karakterizohet nga cilësia dhe garancia;
- Të shpjegojë rolin e vendosjes së çmimeve konkurruese të prodhimeve, për të siguruar shitjet;
- Të shpjegojë rëndësinë e shpërndarjes së produktit blegtoral;
- Të shpjegojë produktet tipike, me origjinë të mbrojtur me tregues gjeografik dhe mbrojtjen e origjinës gjeografike;
- Të bëjë dallimin ndërmjet emërtimeve të ndryshme të produkteve të territorit: tradicionale, me origjinë të mbrojtur, me tregues gjeografik të mbrojtur dhe lokal;
- Të argumentojë impaktin ekonomik që jep promovimi i produkteve të territorit në ekonominë lokale dhe prodhuesit e vegjël;
- Të përshkruajë standardet e produkteve tipike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

- Të argumentojë rëndësinë që ka marketingu i produkteve tradicionale ne marketingun e territorit;
- Të përshkruajë procedurat, kriteret dhe organizmat e regjistrimit dhe çertifikimit të produkteve tipike.

Parimet e etikës profesionale dhe organizimit të punës

- Të shpjegojë rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes së uniformës;
- Të përshkruajë parimet kryesore të etikës profesionale në punë;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës personale;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës të mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të mjeteve të punës;
- Të dallojë materialet e nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive;

Mbrojtja e mjedisit gjatë punës

- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit të mbetjeve për mbrojtjen e mjedisit;
- Të shpjegojë mënyrën e trajtimit të mbetjeve të lëngshme në një fermë për prodhim qumështi;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së makinave mjelëse;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës gjatë punës për mbrojtjen e mjedisit në fermë;

Sigurimi teknik dhe situatat emergjente në fermë

- Të shpjegojë termin “sigurimi teknik”;
- Të identifikojë sistemet, pajisjet dhe objektet e përfshira në sigurimin teknik në një fermë blegtorale;
- Të përshkruajë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik në ambientet e punës;
- Të rendisë masat në rastet e emergjencave në fermë (zjarreve, përmblyjeve, ndërprerjeve të energjisë elektrike gjatë mjeljes apo ndonjë procesi tjetër);

Shpendët

- Të përshkruajë rëndësinë e rritjes, karakteristikat dalluese të racave të shpendëve dhe leverdinë ekonomike që ka rritja e tyre;
- Të rendisë hallkat kryesore të mbarështimit të shpendëve ;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik e fiziologjik të trupit të shpendëve;
- Të klasifikojë racat e shpendët sipas drejtimit të prodhimit;
- Të listojë burimet e elementeve ushqyes për shpendët;
- Të përshkruajë etapat e hartimit të një racioni ushqimor në shpendë;
- Të përshkruajë racionet ushqimore të përcaktuara për shpendët sipas prodhimit dhe kategorive;
- Të përshkruajë çrregullimet nga të ushqyerin jo korrekt të shpendëve;
- Të rendisë sistemet e mbarështimit të shpendëve;
- Të përshkruajë kushtet minimale që duhet të plotësojë një strehim për rritjen e shpendëve;
- Të përshkruajë sëmundjet kryesore në shpendë;
- Të përshkruajë programin e vaksinimeve në shpendë;
- Të rendisë faktorët e mjedisit që ndikojnë në prodhimin e vezëve e të mishit;
- Të shpjegojë metodat kryesore të grumbullimit të vezëve në një fermë shpendësh;
- Të përshkruajë masat që duhet të merren për zëvendësimin e tufës së broilerave;

- Të përshkruajë të ushqyerit e brojlerave sipas fazave të rritjes;
- Të përshkruajë kërkesat për strehimet për shpendët sipas kategorive dhe drejtimit të prodhimit;
- Të përshkruajë kushtet higjienike dhe masat te tjera profilaktike për sistemin e prodhimit të brojlerave;
- Të listojë detyrat ditore rutine që duhet të kryejë në një fermë të rritjes së brojlerave.
- Të përshkruajë procesin e inkubacionit (temperatura, lagështia, testimi, çelja) në një fermë të rritjes së shpendëve;
- Të rendisë arsyet për defektet në çeljen e vezëve;
- Të përshkruajë kushtet që duhet të plotësohen për një rritje normale të zogjve;
- Të rendisë problemet gjatë rritjes;
- Të listojë të dhënat që duhet të regjistrohen në një ferme të rritjes së shpendëve;
- Të përshkruajë metodat e shumëzimit tek shpendët;
- Të bëjë dallimet mes çeljes natyrore e asaj artificial;
- Të listojë kriteret për vezët e selektuara për inkubim;
- Të përshkruajë karakteristikat e pulave për inkubim nga pulat e tjera;
- Të përshkruaje si krijohet një ambient i përshtatshëm për çeljen e zogjve dhe pajisjet që duhen;

Gjedhi

- Të përshkruajë rëndësinë e rritjes së gjedhit karakteristikat dalluese të racave të gjedhit dhe efektivitetit ekonomike të rritjes së tyre;
- Të klasifikojë racat e gjedhit sipas drejtimit të prodhimit;
- Të përshkruajë karakteristikat e eksteriorit sipas drejtimit të prodhimit;
- Të përshkruajë klasifikimin e kondicionit trupor të kafshëve me shkallë;
- Të rendisë kriteret e vlerësimit të pamjes së jashtme të kafshëve sipas ICAR³
- Të përshkruajë kurbën standarde të laktacionit;
- Të rendisë faktorët që ndikojnë në rritjen e prodhimit të qumështit në përputhje me kurbën e laktacionit
- Të shpjegojë rëndësinë e periudhës së tharjes si domosdoshmëri për laktacionin e ardhshëm;
- Të përshkruajë ndikimin e laktacionit në kërkesat ushqimore;
- Të tregojë në cilin laktacioni arrihet prodhimtaria më e lartë e qumështit gjatë gjithë jetës prodhuese;
- Të përshkruajë cilësinë e qumështit dhe faktorët që ndikojnë në të;
- Të përshkruajë përbërjen e qumështit, me referencë karakteristikat të cilat ndryshojnë, si densiteti, ngarkesa bakteriale, pastërtia kimike, qelizat somatike, aromat;
- Të përshkruajë kushtet higjienike të kafshëve, ambientit të mjeljes dhe magazinimit të qumështit;
- Të përshkruajë procedurat para, gjatë mjeljes dhe pas saj, si dhe tharjes së lopëve;
- Të përshkruajë performancën riprodhuese optimale te mëshqerrave në ndërzimin e parë, moshë dhe peshë trupore, si dhe ndikimi I tyre në prodhimtarinë gjatë jetës;
- Të përshkruajë përbërjen dhe funksionin e aparatit tretës sipas llojeve të kafshëve të fermës dhe kërkesat e të ushqyerit;
- Të përshkruajë teknikat e përdorura për të llogaritur tretshmërinë e ushqimeve të kafshëve;
- Te rendisë përbërësit kryesorë të ushqimeve dhe vlerat ushqimore të tyre;

³ ICAR - (International Committee for Animal Recording)

- Të shpjegojë rolin e ujit në të ushqyerin e kafshëve;
- Të rendisë komponentët kryesore për të hartuar racionet ushqimore sipas llojeve, kategorive dhe gjendjes fiziologjike të kafshëve të fermës;
- Të përshkruajë kërkesat ushqimore sipas prodhimtarisë së qumështit dhe për shtesë peshe, nevojat për ujë;
- Të listojë etapat për llogaritjen e racioneve duke bërë shpjegimet përkatëse;
- Të tregojë ndikimin që kanë ushqimet më të përdorshme në të ushqyerit e gjedhit;
- Të përshkruajë nevojat ushqimore sipas grup moshave të viçave;
- Të përshkruajë kushtet e vendqëndrimit dhe ambienteve, strehimet e viçave sipas standardeve minimale;
- Të përshkruajë mënyrat e trajtimit të viçave sipas drejtimit kryesore të prodhimit të viçave për mish.

Dhentë dhe Dhitë

- Të përshkruajë sistemet e mbarështimit të dhenve dhe dhive;
- Të përshkruajë nevojat energjetike, proteinike të dhenve për mirëmbajtjen e trupit, mbarasmërinë, prodhimin e qumështit e shtesën e peshës;
- Të klasifikojnë ushqimet më të përdorshme të dhenve dhe dhive;
- Të përshkruajë racat e dhive dhe dhive, si dhe rëndësinë ekonomike të rritjes së tyre;
- Të shpjegojë të ushqyerit e dhive dhe dhive gjatë periudhave të ndryshme të vitit, sipas gjendjes fiziologjike të tyre;
- Të rendisë kriteret për klasifikimin e leshit, llojet e qimeve;
- Të rendisë kushtet kryesore në të ushqyerit e kecape;

Derrat

- Të shpjegojë rëndësinë e mbarështimit të derrave dhe veçoritë biologjike të tyre;
- Të përshkruajë racat e derrave dhe karakteristikat dalluese;
- Të krahasojë sistemin e tretjes së derrave me atë të ruminantëve;
- Të përshkruajë nevojat ushqimore sipas gjendjes fiziologjike të derrave;
- Të rendisë ushqimet më të përshtatshme që përdoren për derrat;
- Të përshkruajë racionin ushqimor të derrave me ushqimet e disponueshme të fermës;

Kuajt

- Të dallojnë racat e kuajve dhe rëndësinë e mbarështimit të tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e mbarështimit të kuajve;
- Të përshkruajë rëndësinë e mbarështimit të kuajve sportiv dhe kushtet e rritjes së tyre.

Bleta

- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të rritjes së bletës dhe përbërjen e familjes “bletë”;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik të bletës;
- Të rendisë kushtet që duhen krijuar për shtimin intensiv të bletës;
- Të theksojë përparësitë e shtimit artificial të bletës;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit pranveror dhe dimëror në parkun e bletëve;
- Të klasifikojë sëmundjet e bletëve;

Riprodhimi i kafshëve

- Të përshkruajë objektin e studimit të riprodhimit të kafshëve dhe ndërtimin anatomik të organeve gjinore femërore dhe mashkullore;
- Të përshkruajë funksionin dhe fiziologjinë e organeve gjinore femërore dhe mashkullore;
- Të shpjegojë kuptimin e pjekurisë seksuale dhe asaj trupore të kafshëve;
- Të përshkruajë fazat e ciklit seksual;
- Të tregojë karakteristikat e ciklit seksual të kafshëve bujqësore;
- Të përshkruajë shenjat dhe ndryshimet që manifeston një kafshë që është në afsh;
- Të përshkruajë mënyrat e ndërimit;
- Të përshkruajë periudhat e zhvillimit embrional dhe të frytit tek kafsha barse;
- Të përshkruajë ndryshimet anatomike dhe fiziologjike në kafshët barse;
- Të përshkruajë zgjatjen e mbarsmërisë në kafshë të ndryshme;
- Të përshkruajë mënyrat e trajtimit dhe kujdesit për kafshën barse;
- Të përkufizojë procesin e pjelljes;
- Të tregojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes;
- Të përshkruajë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe trajtimin e të porsalindurve;
- Të përkufizojnë dështimet në kafshë;
- Të shpjegojë shkaqet dhe llojet e dështimeve në kafshë;
- Të përshkruajë shenjat klinike në pjelljet e vështira;
- Të përshkruajë metodat gjatë ndërhyrjeve në pjelljet e vështira;
- Të rendisë shkaqet e problemeve shëndetësore tek kafshët e porsalindura;
- Të përshkruajë shenjat klinike në kafshët e porsalindura me probleme shëndetësore;
- Të përshkruajë tiparet që janë objekt i përmirësimit gjenetik;

Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve

- Të shpjegojë rëndësinë e mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve në fermë.
- Të specifikojë aktet ligjore dhe nënligjore që veprojnë në fushën e mirëqenies së kafshëve.
- Të listojë pesë liritë, mbi bazën e të cilave vlerësohet mirëqenia e kafshëve në çdo sistem blegtoral.
- Të rendisë detyrat e punonjësit të fermës gjatë inspektimit të vendit apo ambientit ku qëndrojnë kafshët.
- Të përshkruajë thelbin dhe natyrën e sëmundjes.
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore të kafshëve.
- Të përshkruajë konceptin e profilaksisë kundër sëmundjeve infektive.
- Të shpjegojë llojet e profilaksisë për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme në një fermë blegtorale.
- Të identifikojë burimet e infeksionit të kafshët.
- Të argumentojë masat për profilaksinë e veçantë.
- Të krahasojë karantinën me izolimin.
- Të shpjegojë masat e tjera parandaluese si: kushtet për kafshët e sëmura, personelin e duhur, asgjësimin e kufomave, grumbullimi e përpunimi biotermik i plehut etj.;
- Të listojë mënyrat e asgjësimit të kafshëve, materialeve dhe mbeturinave me djegie.
- Të shpjegojë rëndësinë e masave veterinarë, për mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të përbashkëta për njerëz dhe kafshë.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Parimet e etikës profesionale dhe organizimit të punës

- Të zbatojë rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes së uniformës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të higjienës së mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të përdorë pajisjet kryesore në vendin e punës;
- Të organizojë në mënyrë ekonomike vendin e punës;
- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe materialet e nevojshme;
- Të pastrojë vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë;
- Të zbatojë mënyrat e ndarjes së mbeturinave sipas llojit të tyre;
- Të zbatojë legjislacionin e punës në të gjithë elementët e tij.

Ekonomia në fermën e kafshëve dhe shpendëve.

- Të hartojë një plan biznesi për një njësi ekonomike që mbarështron kafshë dhe shpend, në varësi të kushteve klimatike dhe prioriteteve të zonës;
- Të kryejë një analizë të thjeshtë mbi anët e forta dhe të dobëta, mundësitë për ngritjen dhe menaxhimin e një ferme blegtorale;
- Të hartojë një pasqyrë të thjeshtë ardhurash dhe shpenzimesh;
- Të realizojë kostot e prodhimit dhe shërbimit në fermën blegtorale, sipas një plani të përcaktuar paraprakisht;
- Të kryejë shpërndarjen e punës në biznes, sipas aftësive dhe kapacitetit të burimeve njerëzore në dispozicion.

Marketingu

- Të hartojë një plan marketingu të prodhimit dhe shërbimit në fermë me mënyrat dhe mjetet më të efektshme (spote televizive, fletë palosje, konferenca etj.);
- Të shpërndajë prodhimet blegtorale me mënyrat më të efektshme të mundshme, për t'i shërbyer konsumatorit, në kohën dhe vendin e duhur;
- Të grumbullojë informacion për mendimet e konsumatorit lidhur me arritjet dhe të metat në realizimin e promovimit;
- Të prezantojë produktet bujqësore, blegtorale, etj. duke ruajtur traditën, sipas kushteve dhe prioriteteve që ofron zona;
- Të marrë pjesë në aktivitetet/panairët e organizuar në nivel lokal, rajonal, kombëtar për promovim produktesh blegtorale;
- Të zhvillojë produkte tipike në një territor të dhënë;
- Të zbatojë procedurat, kriteret e regjistrimit dhe certifikimit të produkteve tipike.

Sigurimi teknik dhe situatat emergjente në fermë

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në fermë për procese specifike;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës për çeljen natyrale dhe artificiale të zogjve, si dhe gjatë trajtimit të shpendëve për mish e vezë;

- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik gjatë kujdesit për lopët në laktacion, gjatë mbarshmërisë, në prag të pjelljes si dhe gjatë dhe pas pjelljes;
- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik gjatë procesit të qethjes në të imta;
- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik gjatë mbarështimit të derrave;
- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik gjatë marrjes së mjaltit në zgjua;
- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik gjatë mbarështimit të shpendëve dekorativë;
- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik gjatë mbarështimit të kribave të mëndafshit;
- Të zbatohet planin e masave në rastet e emergjencave në fermë (zjarreve, përmbytjeve, ndërprerjeve të energjisë elektrike gjatë mjeljes apo ndonjë procesi tjetër).

Kujdesi për çeljen natyrale dhe artificiale të zogjve.

- Të përcaktohet radhën e duhur të punës për çeljen natyrale të zogjve;
- Të përzgjedhë mjetet dhe vendin për çeljen e zogjve;
- Të zbatohet të gjitha procedurat për përgatitjen e vendit të vendosjes së vezëve për çelje dhe kllloçkës;
- Të përzgjedhë kllloçkën sipas kondicionit dhe vezët sipas standardit;
- Të vendosë vezët dhe kllloçkën në furrik .
- Të sigurojë ujë dhe ushqim të mjaftueshëm për kllloçkën;
- Të kujdeset për çeljen natyrale të zogjve, duke rrotulluar dhe ajrosur ato pas daljes së kllloçkës nga furriku;
- Të largojë vezët e paçelura;
- Të zbatohet kushtet higjieno-sanitare ambientit, personelit, mjeteve etj., për çeljen artificiale të zogjve në inkubator;
- Të përzgjedhë vezët për inkubacion sipas treguesve dhe t'i vendosë vezët në pozicionin e duhur në karela në inkubator;
- Të kontrollojë parametrat në repartin e inkubacionit (temperaturën, lagështinë, ndriçimin, ventilimin e ajrit);
- Të kontrollojë me kujdes sasinë e vezëve të çelura;
- Të përzgjedhë dhe të vendosë zogjtë e çelur në dhomën e tharjes;
- Të kryejë seksimin e zogjve;
- Të kryejë ambalazhimin e zogjve për transport;
- Të sigurojë higjienën në inkubator pas çeljes së zogjve;

TRAJTIMI I SHPENDËVE PËR PRODHIM MISHI E VEZËSH

Trajtimi i shpendëve për mish

- Të zbatohet radhën e kryerjes së proceseve të punës për trajtimin e shpendëve për prodhim mish;
- Të përzgjedhë ambientin për trajtimin e shpendëve, mjetet, veglat dhe materialet e nevojshme të punës, sipas numrit të krerëve;
- Të sigurojë kushtet zoo-higjienike të ambientit për trajtimin e shpendëve për mish;
- Të seleksionojë shpendët për mish sipas kondicionit të tyre;
- Të përzgjedhë ushqimet e nevojshme për trajtimin e shpendëve për mish, sipas nevojave të grup moshës dhe llojit të shpendëve;
- Të hartojë racionet ushqimore dhe sasinë e ushqimit për trajtimin e shpendëve për mish, sipas grup moshës dhe llojeve të shpendëve;

- Të sigurojë ushqime dhe ujin në sasinë dhe cilësinë e duhur;
- Të shpërndajë racionet ushqimore, sipas orarit të paracaktuar;
- Të nxjerrë shpendët në kullota natyrale;

Trajtimi i shpendëve për vezë

- Të zbatojë radhën e kryerjes së proceseve të punës për trajtimin e shpendëve për prodhim vezësh;
- Të përzgjedhë ambientin dhe materialet për trajtimin e shpendëve për vezë, sipas kriterëve të duhura;
- Të sigurojë kushtet zoo-higjienike të ambientit ku do të trajtohen kafshët (temperaturë, lagështi, shtresë, dezinfektim);
- Të seleksionojë shpendët për vezë sipas kondicionit të tyre;
- Të sigurojë ushqimet dhe ujin në sasi, cilësi e llojshmëri për trajtimin e shpendëve për vezë;
- Të hartojë racionet ushqimore sipas stinës dhe grup moshave të llojeve të shpendëve;
- Të shpërndajë racionet ushqimore sipas vakteve të paracaktuara;
- Të mbledhë dhe grumbullojë vezët;
- Të kontrollojë vezë e grumbulluara për dëmtime të ndryshme;
- Të vendosë vezët nëpër bigerina sipas kërkesës duke i ruajtur në mjediset e duhura;
- Të regjistrojë të dhënat e kërkuara në kartelën përkatëse;

Kujdesi për lopët në laktacion

- Të përzgjedhë racat e përshtatshme për prodhimin dhe kushte të caktuara të fermës;
- Të zbatojë orarin e veprimeve për lopët në laktacion dhe në tharje;
- Të sigurojë parametrat e ambienteve të strehimit të përshtatshme për kafshët;
- Të sigurojë kushte higjieno-sanitare në vendstrehimet dhe trupin e kafshëve, ambientet e mjeljes e ruajtjes së qumështit;
- Të hartojë racionin ushqimor për lopët, sipas fazave të laktacionit;
- Të ushqejë kafshët barse në periudha të ndryshme të mbarsmërisë me racione të caktuara ushqimore;
- Të zbatojë kushtet higjieno-sanitare dhe procedurat para gjatë dhe pas mjeljes;
- Të realizojë mjeljen me dorë ose në mënyrë mekanike;
- Të zbatojë procedurat higjienës, mbrojtjes dhe testimi për mastite para dhe pas mjeljes;
- Të grumbullojë në enë të posaçme qumështin e mjelë;
- Të ambalazhojë qumështin e grumbulluar me mbyllje hermetike për të parandaluar kontaminimin;
- Të ruajë në kushte të caktuara higjieno- sanitare qumështin e grumbulluar;
- Të regjistrojë të dhënat e duhura, në kartelën përkatëse, për çdo lopë;
- Të higjenizojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet që përdorën për pastrimin e lopëve dhe ambientit të tyre;

Kujdesi për viçat

- Të përzgjedhë ambientin e përshtatshëm për viçat e majmërisë duke plotësuar standardet minimale për qëndrimin e tyre;
- Të sigurojë mikroklimën dhe kushtet higjienike në stallë sipas standardit të kërkuar;
- Të përzgjedhë viçat për majmëri, sipas kriterëve të duhura;

- Të përlllogarisë sasinë e ushqimeve dhe llojet e ushqimeve për viçat që mbarështohen për majmëri;
- Të zbatojë racionet ushqimore duke i siguruar sasinë e ushqimit për çdo individ
- të sigurojë sasinë e ujin të pijshëm të nevojshëm për viçat në majmëri;
- Të zbatojë veprimet në përputhje me planin dhe oraret e përcaktuar;
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për secilin viç;
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e viçave për majmëri;

Kujdesi për Dhentë dhe Dhitë

- Të trajtojë delet e dhitë gjatë periudhës së laktacionit;
- Të përlllogaritë sasinë e ushqimit për tufën e dhenve dhe dhive që mbarështohen;
- Të kontrollojë periudhën e mëmëzimit në qengja e keca;
- Të përgatisë racionin ushqimor për dhentë e dhitë në laktacion sipas prodhimit të qumështit;
- Të ushqejë kafshët në stalla, sipas vakteve të caktuara;
- Të realizojë kullotjen e lire të deleve dhe dhive në periudhën e laktacionit;
- Të kujdeset për qengjat dhe kecat gjatë pirjes së kulloshtrës, në sasinë dhe kohën e duhur;
- Të shkëputë qengjat dhe kecat nga nënat, në kohën e duhur;
- Të kontrollojë peshën trupore të qengjave e kecape dhe kohën e shkëputjes nga nëna;
- Të zbatojë procedurat para, gjatë dhe pas mjeljes ne dele dhe dhi;
- Të regjistrojë sasinë ditore të qumështit të mjelë, në kartelën përkatëse;
- Të grumbullojë qumështin e mjelë në enë të posaçme;
- Të ruajë qumështin në kushtet e duhura higjiëno-sanitare;
- Të paketojë qumështin për treg, sipas standardit;
- Të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse;
- Të higjienizojë mjetet e pajisjet që përdorën gjatë trajtimit të deleve e dhive në periudhën e laktacionit;

Procedurat mbi Qethjen e dhenve

- Të zbatojë teknikat e qethjes së dhenve me gërshtë dore e makinë qethëse;
- Të kontrollojë me kujdes gjendjen e përgjithshme të dhenve dhe lëkurën për sëmundje të ndryshme;
- Të fiksojë dhentë në pozicionin e duhur për qethje;
- Të qethë dhentë në mënyrë uniforme me gërshtë dore;
- Të kryejë mjekimin e dhenve në raste lëndimesh gjatë qethjes;
- Të pastrojë vendin, gërshtët, makinën qethëse pas qethjes dhe t'i dezinfektojë ato;
- Të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse;
- Të grumbullojë sasinë e leshit të dhenve në vendin e duhur duke larguar papastërtitë e të përvjelat;
- Të paketojë siç duhet produktin (leshin);

Kujdesi për Derrat

- Të përzgjedhë ambientin e përshtatshëm për derrat e majmërisë duke siguruar kushtet minimale për ta;
- Të sigurojë kushtet higjiëne dhe mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar;

- Të përzgjedhë derrat për majmëri, sipas kritereve të duhura;
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave;
- Të sigurojë uji të pijshëm dhe ushqime në sasi dhe cilësi për derrat në majmëri.;

Përmirësimi racor

- Të përzgjedhë riprodhuesin e përshtatshëm për tufën;
- Të regjistrojë të dhënat individuale të kafshëve për prodhim dhe riprodhim
- Të përgatisë planin e çiftëzimeve;
- Të zbatojë planin e çiftëzimeve;

Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve të fermës

- Të zbatojë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqenies së kafshëve për mbarështimin, prodhimin, përdorimin, shitjen, therjen, eliminimin dhe transportin, sipas llojeve të ndryshme të kafshëve.
- Të kujdeset për kafshët e fermës, gjatë transportit, në treg dhe në therje.
- Të kontrollojë gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kafshëve të fermës, pajisjet, vendndodhjen apo ambientin ku ato rrinë, minimalisht dy herë në ditë;
- Të dallojë ndryshimet në shëndetin e kafshëve të fermës (ndryshimi i qimes, lëkura, sjellja, etj.), si dhe qëndrimin e tyre në hapësira jo të pamjaftueshme gjatë të ushqyerit, pushimit, transportit, mjeljes etj.
- Të zbatojë masat profilaktike veterinarë, sipas një plani masash veterinarë të miratuara.
- Të vendosë kafshët e importuara në karantinë për të kryer ekzaminimet e nevojshme veterinarë.
- Të izolojë kafshët e prekura ose të dyshuara, si të prekura nga një sëmundje infektive, e përcaktuar në listën përkatëse, sipas udhëzimeve të specialistit veterinar.
- Të kryejë procesin e heqjes së brirëve të kafshët e reja (viça, qengja, keca) në ditët e para pas lindjes, sipas udhëzimeve të specialistit veterinar.
- Të kryejë heqjen e brirëve me kauterizim (djegie me hekur të nxehtë) ose me pajisje elektronike.
- Të trajtojë plagën nga heqja e bririt, sipas udhëzimeve të specialistit veterinar.
- Të kujdeset për kafshët, duke ndaluar veprimet që mund të shkaktojnë dhimbje, vuajtje ose dëmtime të tyre.

RIPRODHIMI

Përmirësimi racor

- Të përzgjedhë riprodhuesin e përshtatshëm për tufën;
- Të regjistrojë të dhënat individuale të kafshëve për prodhim dhe riprodhim
- Të përgatisë planin e çiftëzimeve
- Të zbatojë planin e çiftëzimeve

Zbulim i afshit

- Të përcaktojë planin e punës për zbulimin e shenjave të afshit tek lopët;
- Të përcaktojë lopët që planifikohen në afsh, për vrojtim;
- Të mbajë shënimet për lopët e delet e vrojtuar;
- Të identifikojë lopët me shenja afshi;

Kujdesi për lopët gjatë mbarësmërisë.

- Të përcaktojë kohëzgjatjen e mbarsmërisë në kafshët e ndryshme të fermës;
- Të sigurojë kushtet higjieno–sanitare në vendstrehimet, vendqëndrimet e kafshëve, si dhe në vendet ku hidhet ushqimi, uji, ... etj.;
- Të kryejë procesin e tharjes në lopë, sipas procedurave të përcaktuara në këtë drejtim;
- Të përzgjedhë dhe të racionojë ushqimet për lopët sipas periudhave të ndryshme të mbarsmërisë;
- Të sigurojë ushqime të pastra nga myqet, trupa të tjerë të huaja, kalbje, të ngrira, etj.;
- Të nxjerrë lopët për lëvizje;
- Të vendosë lopët në periudhën e tharjes në ambiente të caktuara;
- Të ushqejë lopët në tharje me racione me përmbajtje të ulët energjetike dhe proteinike
- Të regjistrojë të dhënat në kartelën përkatëse;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për lopët gjatë mbarsmërisë;

Kujdesi për lopën para, gjatë dhe pas pjelljes.

- Të zbatojë kushtet higjieno-sanitare për kafshën në maternitet;
- Të kontrollojë gjendjen e gjirit dhe të kafshës në muajin e fundit të mbarsmërisë;
- Të përgatisë ambientin për mbajtjen e kafshëve mbarse në periudhën e fundit të mbarsmërisë;
- Të dallojë shenjat e shfaqura në ditët e fundit para pjelljes;
- Të përzgjedhë ambientin e pjelljes sipas kriterëve të përcaktuara;
- Të përgatisë sipas parametrave vendin e pjelljes;
- Të mbikëqyrë kafshën gjatë fazave të procesit të pjelljes: fazën përgatitore, fazën e lindjes dhe të nxjerrjes së shtratit;
- Të ndërhyjë specialisti veteriner për ta ndihmuar atë duke zbatuar teknikat përkatëse;
- Të dallojë një lindje normale dhe jo normale;
- Të kryejë procesin e shkëputjes së të voglit nga nëna duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse;
- Të zbatojë kushtet higjieno-sanitare pas pjelljes;
- Të trajtojë nënën pas procesit të pjelljes nga ana higjienike dhe ushqimore;
- Të trajtojë të porsalindurit nga ana higjienike dhe ushqimore;
- Të përcaktojë mënyrën e të ushqyerit sipas gjendjes shëndetësorë;
- Të zbatojë të ushqyerin e të porsalindurit me kullostër sipas rregullave të përcaktuara;
- Të monitorojë kafshën pas pjelljes për problemet e riprodhimit, të ushqyerit, etj.;
- Të vendosë të porsalindurin në mjedise të veçanta si bokse të veçante, në profilaktor, në stalla,... etj.;
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse;

Ndërhyrje në zgjua për marrjen e mjaltit.

- Të përzgjedhë vendin ku do kryhet marrja e mjaltit, sipas standardit;
- Të sigurojë higjienën e vendit dhe veglave të punës, sipas standardit;
- Të përgatitë siç duhet veshjen speciale për ndërhyrje në zgjua;
- Të ndërhyjë në zgjua sipas radhën së përcaktuar të punës;
- Të hapë me kujdes zgjoin;
- Të nxjerrë me kujdes kornizat nga zgjoi;
- Të transportojë me kujdes kornizat në centrifugë;

- Të vendosë kornizat në pozicionin e duhur në centrifugë;
- Të centrifugojë hojet e bletëve;
- Të nxjerrë me kujdes hojet nga centrifugimi;
- Të vendosë me kujdes kornizat në vendin e caktuar për tharje;
- Të kullojë dhe grumbullojë mjaltin në enë të veçanta;
- Të transportojë enët e mjaltit në vendin e caktuar;
- Të kryejë pastrimin e mjeteve të punës të përdorura gjatë vjeljes së mjaltit;

Kujdesi dhe të ushqyerit për zogjtë dekorativ

- Të ndërtojë kafazin për çiftin e pëllumbave sipas standardit;
- Të zgjedhë ambientin e duhur për vendosjen e kafazit;
- Të përzgjedhë racën e pëllumbave që do të mbarështojë;
- Të mbikëqyrë çiftëzimin e pëllumbave në periudha të caktuara të vitit;
- Të kontrollojë procesin e pjelljes së vezëve;
- Të kujdeset për rritjen e zogjve të sapoçelur të pëllumbave;
- Të kryejë shërbime klimatike në kafaz si sigurimi i dritës natyrale, i ajrimit, i temperaturës;
- Të vendosë në kafaz tasa balte me kashtë dhe me pluhur dezinfektues për parazit;
- Të pastrojë kafazin nga jashtëqitjet e pëllumbave dhe mbeturinat ushqimore;
- Të zbatojë masat profilaktike duke përdorur vaksinat si tek shpendët;
- Të përcaktojë enët e ushqimit dhe të ujit për pëllumbat;
- Të përzgjedhë ushqimet e njoma dhe të koncentruara në çdo kohë;
- Të përdorë vitaminat në ujën e pijshëm (3 ditë në javë);
- Të vendosë në kafaz enë me tulla të thyera, zhavorr, qymyr druri, kripë, etj., për të plotësuar nevojat me lëndë minerale;
- Të kujdeset për shtimin dhe ushqyerjen e papagajve;
- Të përzgjedhë kafazin e sipas numrit të papagajve që mbarështon;
- Të përcaktojë periudhën e çiftëzimit të papagajve;
- Të përcaktojë periudhën e inkubimit të vezëve;
- Të trajtojë zogjtë e papagajve në inkubator;
- Të përzgjedhë teknikat e të ushqyerit të papagajve;
- Të ushqejë të vegjlit në inkubator me shiringë nga goja;
- Të ushqejë papagajtë në kafaz me fruta dhe perime të freskëta;
- Të përdorë vitaminat pluhur me ushqime të buta disa here në javë si dhe bllok mineral, pluhur Ca në periudhën e shtimit me vezë;
- Të kryejë pastrimin mekanik të kafazit të papagajve nga jashtëqitjet dhe mbeturinat ushqimore;
- Të zbatojë masat profilaktike si vaksinimet dhe mjekimet në momentin e duhur;

Kujdesi dhe rritja e krimbit të mëndafshit

- Të përgatisë lokalin për rritjen e krimbit të mëndafshit sipas parametrave të duhura;
- Të sigurojë në sasi dhe cilësi ushqimin e nevojshëm për rritjen e krimbit të mëndafshit: gjethe dhe lastarë mani;
- Të ruajë parametrat e dendësisë të kribave për njësi të sipërfaqes;
- Të kujdeset për çeljen, rritjen dhe ushqyerjen e krimbit të mëndafshit;
- Të zbatojë rregullat tekniko-higjienike gjatë fazave të ndryshme të rritjes së krimbit të mëndafshit;

- Të kryejë tërheqjen e farës nga stacioni i rritjes së krimbit të mëndafshit;
- Të vendosë mbi farën e çelur, letrat e biruara për mbledhjen e krimbave të porsaçelur;
- Të vendosë gjethet e grira të manit mbi letrat e biruara;
- Të kryejë mbledhjen e larvave të çelura;
- Të vendosë larvat e çelura sipas moshës mbi shtretërit e rritjes;
- Të kryejë ndërrimin e shtresës (letrës së biruar) sipas moshave të ndryshme;
- Të sigurojë sasinë e ushqimit (gjetheve dhe degëzave të manit) sipas moshave të ndryshme të tij;
- Të ruajë dendësinë e krimbave për njësi të sipërfaqes së shtretërve;
- Të kryejë kontrolle për evidentimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të krimbit të mëndafshit;
- Të zbatojë masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të eliminojë krimbat sipas ngjyrës së lëkurës, jashtëqitjes dhe zhurmës karakteristike në të ecur dhe të ushqyer;
- Të kujdeset për endjen e mëshikëzës së krimbit të mëndafshit dhe grumbullimin e tyre;
- Të konstatojë momentin e përgatitjes së krimbit të mëndafshit për endjen e mëshikëzës;
- Të sigurojë materialet e nevojshme për ngritjen e pyllit (degëza të thata mani, gjineshtre, dushku, shqope, kashtë thekre);
- Të kryejë ndërtimin e pyllit (mëshikoreve) për endjen e mëshikëzës;
- Të kryejë mbledhjen e mëshikëzave në afate të ndryshme, në varësi të qëllimit të përdorimit të tyre (për industri dhe për prodhim fare);
- Të grumbullojë mëshikëzat sipas cilësisë, madhësisë, pastërtisë dhe formës së tyre;
- Të kryejë transportin mëshikëzave në pikat e grumbullimit sipas afateve të përcaktuara ;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;

- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;